

community

The New Apostolic Church around the world

04/2020/AI

Pentakosti 2020 Shpirti i clirimit



Kryeartikulli
Besnikëria e Perëndisë

Shërbesa fetare
Të dëshmosh dhe të duash

Doktrina kishtare
Një kishë ku ndjehesh mirë

New Apostolic Church
International



Besnikëria ndaj Perëndisë na çon në bashkimin me të

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

„Besnik është Perëndia, nga i cili jeni thirrur në bashkësinë e Birit të tij Jezu Krishtit, Zotit tonë“ (1. Korint 1,9). Kur unë lexoj këtë tekst nga bibla mendoj për të gjithë ju. Secili prej nesh bën jetën e vet. Ka të përpjeta e tatëpjeta, të cilat janë të mbushura me frikë por edhe me gëzime. Ngushëllimi ynë është: Perëndia është besnik! Ai bën atë që thotë. Por meqënëse jemi njerëz nuk e ndjejmë edhe fort këtë gjë, pasi ne jemi në gjendje të kuptojmë vetëm një pjesë fare të vogël të planit të madhe hyjnor, që ai e ka gati për ne.

Perëndia është ai që na ka thirrur për të qenë të bashkuar me Birin e tij Jezu Krishtin. Ai na thërrret, ai na zgjedh – dhe jo e kundërtat. Ai njeh secilin prej nesh më mirë se sa e njohim ne veten tonë dhe di çdo gjë rreth nesh. Dhe ai i le secilit lirinë për ta ndjekur ose jo thirrjen e tij.

Perëndia na bën thirrje për t'u bashkuar me Jezu Krishtin, Zotin tonë. Këtë e ka pohuar edhe vetë Jezusi: Ai dësheron, që ne të jemi atje, ku është edhe ai. Por edhe tani e këtu ne jemi tashmë të bashkuar me Birin e Zotit tonë. Ne jemi të bashkuar me të në çdo situatë të jetës sonë:

- Ne luftojmë edhe në vuajtjet tona, për të qëndruar të bashkuar me Zotin.
- Ne e mbështesim Jezusin në detyrën e tij dhe e shpallim Ungillin, duke bërë të mira.
- Ne nuk e harrojmë për asnjë kohë misionin tonë, përkundrazi e kemi kthyer atë në priorititetin tonë.

Perëndia na bën thirrje për në bashkësinë e besimtarëve – për në kishë:

- Ne duam të jemi dhe të veprojmë sëbashku, të lutemi të gjithë bashkë, të festojmë e të punojmë sëbashku.
- Ne dëshirojmë ta fuqizojmë këtë unitet dhe të luftojmë kundra grindjeve: Ne shëmangim thashthemet, lemë të kaluarën të pushojë dhe flasim për të mirën dhe jo të keqen.
- Ne i shërbjmë njëri-tjetrit dhe nuk bëjmë dallime ndërmjet motrave dhe vëllezërve: të gjithë mund të kontribuojnë në mirëqenien e bashkësisë

Së fundi Perëndia na bën thirrje edhe në marrjen sëbashku të Darkës së Shenjtë:



Foto: NAK International

- Ajo është një shijim i vaktit të Dasmës së Qengjit.
- Ajo na kujton se Krishti ndau gjithçka me njerëzit, përfshirë vuajtjet dhe vdekjen.
- Ajo na jep forcë për të luftuar në mënyrën që edhe ai luftoi.
- Ajo forcon bashkësinë vëllazërore midis njëri-tjetrit. Për të gjithë ka të njëjtën bukë dhe të njëjtën verë dhe një festë të Darkës së Shenjtë. Çfarë do të kishim bërë pa bashkësinë?

Të falenderoj, o Zot, që më ke dhënë mundësinë të jem pjesë e këtij bashkimi.

Të fala të përzemërtë

Jean-Luc Schneider



Foto: Marcel Feide



2. Korint 3,17

„Sepse Zoti është Fryma;
dhe atje ku është Fryma e Zotit,
atje është liria.“

Të dëshmosh, të rrëfesh dhe të duash

Të dashur vëllezër e motra, është me të vërtetë diçka e veçantë të festosh Pentakostin në këtë mënyrë. Normalisht ne jemi mbledhur që të festojmë ardhjen e Shpirtit të Shenjtë këtu në tokë, gjë që është cilësuar edhe si ditëlindja e kishës së Krishtit. Ne lutemi dhe këndojmë së bashku, ne adhurojmë Perëndinë dhe jemi mësuar që të marrim një bekim të veçantë nga Ati ynë qiellor në ditën e Pentakostit. Ne jemi të bekuar që na jepet mundësia për t'u mbledhur të gjithë si një bashkësi e madhe, që dëgjojmë fjalën e Zotit, që marrim Darkën e Shenjtë për vete dhe për shpirrat e larguar nga kjo jetë. Porse Zoti na i ndryshoi të gjitha planet tona, dhe ne nuk mund të mblidhemë të gjithë së

bashku, nuk mund të marrim së bashku Darkën e Shenjtë Shenjtë për vete dhe për shpirrat e larguar nga kjo jetë dhe nuk kemi asnjë shpjegim për këtë – së paku unë nuk kam. E vetmja gjë që mund të bëjmë është, të jemi të përurur përparrë dorës së Perëndisë. Le të kujtojmë këtu për një moment gruan nga Kanaani, e cila erdhi tek Jezusi me lutjen për t'ia shëruar vajzën e sëmurë. Jezusi e refuzoi në fillim, pasi ajo qe johebreje. Si pasojë gruaja tha: Kur nuk mund të kesh dot bukë, atëhere duhet të jem e kënaqur edhe me thërrime. Kur Jezusi vuri re besimin e saj, ajo mori atë që i kërkoi atij (krhs. Mateu 15,21).

Në këto moment ne nuk mund të marrim një menu të plotë bekimesh. Se për çfarë arësy, nuk e dime, Zoti vendosi: Ju do të mjaftoheni tanë për tanë me thërrime. Por ne kemi besim të plotë tek Ati ynë dhe themi: Nëse ne marrim thërrime, atëhere jemi të bekuar edhe për këto thërrime. Natyrish që kemi dëshirën e madhe për të marrë një Menu të plotë, All-inclusive dhe lutemi që ta marrim atë sa më shpejt që të jetë e mundur. Unë e kam thënë: Perëndia na i ndryshoi planet tonë; kjo është e vërtetë për shumicën, për shumë motra e vëllezër. Një njeri i dashur i tyre ka vdekur, të tjerë kanë humbur paratë ose burimin e vetëm të fitimit të tyre. Në shumë rajone të tokës njerëzit nuk mund të fitojnë bukën e gojës. Planet tonë u ndryshuan prej Zotit – porse planin e tij Zoti nuk e ka ndryshuar. Ai dëshiron ta çojë popullin e tij në mbretërinë e tij. Ai dëshiron të na ngushëllojë, të na fuqizojë dhe bekojë, dhe këtë do ta bëjë. Shpirti i Shenjtë na kujton: Ti je një fëmijë Zoti, Ati yt qellor nuk do të t'harrojë!

Le të festojmë tanë Pentakostin dhe le të trajtojmë fjalën e marrë nga bibla (Leximi i Biblës nga Vep. e apost. 2,1–4, 12–21).

Po, Pentakosti i parë qe edhe hapi i parë i rëndësishëm në planin e Perëndisë për shpëtimin e njerëzve. Ati dhe Biri i tij derdhën, sollën Frymën e Shenjtë në tokë, ashtu si e kish dërguar më parë Ati birin e tij në tokë. Natyrish që Fryma e Shenjtë dhe Biri kishin qenë përherë një me Atin dhe kishin kryer punën e tyre në tokë. Por ne e dimë, se Perëndia At e dërgoi Birin e tij në tokë me një detyrë të caktuar:

Biri u bë njeri, me qëllim që të shpallte vullnetin e Atit të tij. Ai thoshte: Doktrina ime nuk vjen prej meje, përkundrazi unë ju them atë që është doktrina e Atit tim (krhs. Gjoni 7,16).

Detyra e dytë e Birit të Perëndisë ishte, t'i mblidhët njerëzit dhe t'i drejtonte drejt mbretërisë së tij.

Detyra e tretë qe, të sakrifikonte jetën e tij, me qëllim që të krijonte mundësinë për njerëzimin për të ardhur tek Zoti. Sapo e përbushi edhe këtë detyrë, ai u kthy përsëri pranë Atit të vet. Pastaj Perëndia dërgoi në tokë Frymën e vet-përsëri me një detyrë të veçantë:

Detyra e Frymës së Shenjtë është të shpallë vullnetin e Perëndisë. Jezusi ju tha një herë dishepjve të tij: Unë mund t'ju kisha thënë shumë gjëra, porse Shpirti, Fryma do të vijë dhe do t'ju drejtojë drejt së vërtetës (krhs. Gjoni 16, 12.13).

Detyra e dytë e Frymës së Shenjtë është që të mbledhë popullin e Zotit së bashku. Nëpërmjet forcës së Frymës së Shenjtë populli i Zotit i është shtuar trupit të Krishtit.

Detyra e tretë është, që të përgatisë bashkësinë nuse të Krishtit. Fryma e Shenjtë do të krijojë brenda nesh atë Krijesë të re, e cila në natyrën e saj do t'i ngjasojë gjithnjë e më shumë imazhit të Jezusit, me qëllim që ne të mund të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë.

Fryma e Shenjtë vepron si një forcë, ajo është e padukshme. Ajo vepron tek vetë njerëzit por edhe nëpërmjet tyre. Për të përbushur këto tri detyra ajo ka nevojë për njerëzit. Për këtë ajo zgjedh njerëzit, i mbush ata me frymën e tij, i shenjtëron dhe i afteson ata për t'u bërë vegla në dorën e tij, me qëllim që të realizojë planin e tij të shpëtimit. Kjo u bë mëse e qartë në ditën e Pentakostit. Ata, që u mbushën me Frymën e Shenjtë filluan që atë ditë të predikonin. Ata e shprehën vullnetin e Perëndisë pa pasë frikë. Pjetri u tha jo hebrejnë në ditën e Pentakostit: Ky është Jezusi, të cilin ju nuk e deshët, të cilin ju e kryqëzuat, Perëndia e dërgoi atë si Zotin dhe Mesinë. U tha me siguri që Jezusi ishte Biri i Perëndisë dhe Perëndia ishte Ati i tij. Në këtë mënyrë i fuqizoi dhe i aftesoi Fryma e Shenjtë Pjetrin dhe të tjerët për të shpalluar pa frikë vullnetin e Perëndisë (krhs. Vep. e Apost. 2,22–36).

E njëjtë gjë kish ndodhur edhe një herë tjetër me Stefanin, i cili vdiq, dha jetën e tij për besimin (krhs. Vep e apost 7,1). Po kështu ndodhi edhe me Filipin, i cili i shpalli të dërguarit të Zotit nga Etiopia vullnetin e Perëndisë. Më vonë të katër vajzat e Filipit shërbjen si profete (krhs. Vep e apost 8,29; 21,8.9).



Sot jemi ne të zgjedhurit e Zotit, të cilët duhet të shpallim vullnetin e tij nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Nëse e lejojmë Frymën e Shenjtë të na mbushë shpirtin, atëhere ajo na mundeson pér ta bërë këtë gjë në çdo situatë të jetës. Edhe sot refuzohet Jezusi prej shumë njerëzve. Ata thonë që doktrina e Krishtit nuk përshtatet me kohën në të cilën jetojmë, të tjerë përpiken t'i përshtaten asaj. Kur kujtojnë Jezusin, kujtojnë një njeri i cili bëri mrekulli; ata edhe në këtë mënyrë e lëvdojnë atë. Të tjerë e kanë ndryshur në një fare mënyre Ungillin, me qëllim që të kenë sukses nga ana materiale edhe nëpërmjet tij. Ndërsa ne jemi dërguar pér të çuar më tej Ungillin e vërtetë, ashtu siç e ka përhapur apostulati. Ungilli i vërtetë është modern, është i kohës edhe sot dhe mund të përdoret në çdo situatë.

Dikush mendon se në këtë kohë krize të Koronës do të ndodhë ndonjë ndryshim, duke pasë një kohë para dhe pas Koronës: Ne duhet të mendojmë mirë edhe një herë, se si do të organizojmë situatën shoqërore dhe ekonomike; ne duhet të mendojmë mirë edhe një herë, se si do të shfrytëzojmë burimet tona natyrore; ne duhet të mendojmë mire edhe një here rreth jetës sonë, pasi nuk mund të ecim më në rrugën e egoizmit, pasi është një rrugë pa krye.

Unë nuk e di a do të pësojmë, a do të ndodhë ndonjë ndryshim. Shpresoj, por e di gjithashtu, që njerëzit mbeten njerëz. Le të përbushim edhe në këtë kohë detyrën tonë, të aftësuar prej Shpirtit të Shenjtë, le të shpallim me fjalë e vepra Ungillin e Jezusit. Doktrina e tij është gjithnjë e vlefshme: predikimi mbi mal po ashtu, akoma ka vlerë rregulli i artë. Ne duhet të sillemi në përputhje më këtë kohë. Le të shpallim faktin, që pasuria shpirtërore është shumë më me vlerë se ajo materiale. Sigurisht që ne duhet të mos harrojmë, që fëmijët tanë të ndihen mirë, që të kenë pér të ngrënë, që të shkollohen, kjo është mëse normale. Por le të mos harrojmë: Dhurata më e madhe që mund t'ju bëjmë fëmijëve tanë, është që t'u themi se Jezu Krishti jeton në ta nëpërmjet pagëzimit me Ujë dhe me Frymë. Rruga më e bukur pér t'iu treguar fëmijëve tanë se i duam është, t'uva sjellim atyre Jezusin sa më pranë.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm, se duhet të tregojmë kujdes të madh edhe me burimet natyrore të kësaj bote. Kjo është një shenjë edhe e dashurisë sonë kundrejt Perëndisë dhe ndaj tjetrit. Shpesh më thonë motra e vëllezër: Po, por ne nuk do të rrimë përgjithnjë këtu, i dashur apostul kryesor, ne duam të shkojmë në qiell. Nuk duhet të tregojmë kujdes



Nëpërmjet Frymës së Shenjtë na bëhet e mundur të vemë, të nxjerrim në plan të dytë interesat personale dhe të shërbejmë për të mirën e bashkësisë

të madh për gjërat tokësore, nuk janë të rëndësishme, por më tepër duhet të bëjmë kujdes për shpirtin; pasi duam të shkojmë në qill. Unë ju them: Edhe unë dua të shkoj në qill. Por le të mos harrojmë se gjithnjë e më tutje, edhe pas nesh do të ekzistojnë njerëz këtu në tokë, deri në ditën e Gjygit të Fundit. Njerëzit janë përgjegjës për tokën deri në ditën e Gjygit të Fundit. E për më tepër ne shpresojmë të bëhem i pjesë e priftërit mbretëror, dhe së bashku me Jezu Krishtin të kthehem i përsëri në këtë tokë për të shpallur Ungjillin krah për krah me Zotin Jezus.

A e shikoni pra? Edhe nga këndvështrimi apostolik i ri ka kuptim që të vrasësh mendjen se si do të sillesh me rrugullin tokësor.

Kjo është mënyra se si do të zbatojmë detyrën që morëm nga Biri i Perëndisë dhe nga Fryma e Shenjtë: që të shpallim pa frikë dhe me kurajë që predikimi mbi mal dhe rregulli i artë kanë vlerë edhe sot. Ne duhet të ndërgjegjësohem i vazhdimisht që pasuria shpirtërore është shumë më e



vlefshme se çdo pasuri materiale. Le të sigurohemi se Jezu Krishti jeton edhe në zemrat e fëmijëve tanë, dhe le të kujdesemi edhe për këtë tokë mbi të cilën jetojmë.

Detyra e dytë e Jezusit dhe e Frymës së Shenjtë ishte që të mblidhnin popullin. Jezusi kishte pretendime të mëdha. Ai thoshte: Unë dua që unë dhe populli im të jemi një, në unitet ashtu siç jam unë një me Atin tim. Jezusi dëshëron që kisha e tij të jetë kopje e unititetit, të reflektojë një të tèrë, ashtu siç është vetë i përbërë prej trinisë së tij. Perëndia Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë tri “persona” të ndryshëm shpirtërorë, por që janë në një unitet të plotë. Ne, të cilët jemi të pagëzuar me Ujin dhe Shpirtin e Shenjtë, duhet ta reflektojmë këtë unitet. Natyrisht që ne do të mbesim mëkatarë të dobët dhe uniteti ynë nuk do të jetë kurrë kaq i



përsosur si ai i Perëndisë Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Por nëpërmjet forcës së Shpirtit të Shenjtë në mund të punojmë vazhdimesht për ta kërkuar këtë unitet. Le të kujtojmë në këtë rast të krishterët e parë. Në fillim qenë hebrejtë, pastaj erdhën, të huaj, johebrejtë. Unë besoj se nuk jemi në gjendje të masim, të dimë distancën ndërmjet hebrejnve dhe johebrejnve, romakëve dhe grekëve. Hebrejtë kishin jetuar me një kulturë fetare njëqind vjeçare, ndërsa të tjerët ishin në çdo pikëpamje krejtësisht ndryshe. Jezusi u thoshte atyre: Tani bëhuni një. Unë besoj se ndryshimi ka qenë po kaq i madh, sa ai që ne njohim sot. Ne kemi sot ndryshime që bazohen në statusin shoqëror, në moshën e seksin si edhe orientimet seksuale janë të ndryshme. Edhe për ne janë të mëdha këto ndryshime. Unë nuk jam i sigurt, nëse ky ndryshim është më i madh se sa ai ndërmjet hebrejnve besimtarë dhe johebrejnve. Ne duhet të kujtojmë Jezusin, i cili i tregoi Saulit, se ai, si hebre ishte armiku i tij dhe e përndiqte atë (krhs. Vep e apost 9,3–5.15). Nëpërmjet forcës së Shpirtit të Shenjtë njerëzit e asaj kohe i imposhtën këto ndryshime. Atë, që ata bënë në atë kohë, mund ta bëjmë edhe ne sot.

Në këtë krizë të Koronës ne përjetojmë veçantinë e njerëzimit. Nëse vetëm një person nuk i bindet rregullit, i gjithë komuniteti është në rrezik. Disa njerëz mendojnë se nuk duhet as të flasësh për këtë, nuk njeh askënd që ka Korona. Unë jetoj në një prej rajoneve që është më i prekur, e di se për çfarë po flas. Nëse dikush nuk i respekton rregullat, i gjithë komuniteti është i kërcënuar. Ky është një

shembull i shkëlqyer i trupit të Krishtit. Kur një gjymtyrë vuan, i gjithë trupi është i sëmurë (krhs. 1. Korint 12,26).

Për t'i rënë më shkurt: përmes Frymës së Shenjtë është e mundur që ne të lëmë mënjanë interesat tona dhe t'i shërbejmë të mirës së përbashkët. Në të gjitha rrethanat, le të ndihmojmë që të lemë mënjanë interesat tona private dhe të kontribuojmë në mirëqenien e përbashkët në trupin e Krishtit. Përmes Frymës së Shenjtë ne mund t'i lëmë mënjanë interesat tona dhe t'i shërbejmë komunititetit.

Po kthehem përsëri në vendin tim. Ne në Francë kemi zbuluar se njerëzit të cilëve nuk i është kushtuar aq shumë rëndësi, janë shumë të rëndësishëm për shoqërinë. Ata nuk kishin shumë reputacion, sepse nuk kishin punë me cilësi të lartë dhe si rezultat edhe paga të vogla.

Dhe tani, në këtë krizë, ne po e kuptojmë: se asgjë nuk funksion pa ata. Papritur këta njerëz bëhen shumë të rëndësishëm për ne.

Ka anëtarë, gjymtyrë të ndryshëm në trupin e Krishtit. Disa kanë dhundi të veçanta, të tjerët kanë detyra të veçanta për t'i kryer. Prandaj, të mos harrojmë, kurrë mos të harrojmë se secili anëtar apo gjymtyrë është po aq i rëndësishëm për Zotin, sa edhe tjetri. Dhuntitë dhe detyrat janë të ndryshme, por secili anëtar ka të njëjtën vlerë për Perëndinë, për Zotin Jezus dhe po këtë vlerë duhet të ketë edhe për ne. Kjo ishte detyra e dytë. Mblidhni njerëzit së bashku, kapërceni



mosmarrëveshjet, kapërceni interesat personale për t'i shërbyer të mirës së përbashkët dhe shihni secilin anëtar në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën vlerë.

Detyra e tretë e Frymës së Shenjtë është ndryshimi. Ne e dimë dhe përfjetojmë që Fryma e Shenjtë nuk i ndryshon situatat apo gjendjen në të cilën ndodhemi. Ajo është e fuqishme, por nuk e ndryshon situatën. Por ajo na ndryshon neve. Ajo na jep më shumë forcë dhe më shumë fuqi. Ajo na ndihmon të zhvillojmë krijesën e re brenda nesh për t'u marrë me situatën e re në të cilën ndodhemi. Le të lejojmë që Fryma e Shenjtë të na ndryshojë, të jemi të përgatitur për çdo situatë. Unë thashë që disa njerëz besojnë në ndryshime që do të ndodhin në të ardhmen. Së shpejti do të ketë një ndryshim për të gjithë ne: Ne do të jemi në gjendje të shkojmë përsëri në kishë dhe të adhurojmë Zotin atje. Si do të kthehem në kishat tonë? A duhet të jetë gjithçka ashtu siç ishte më parë? Ne kemi një mundësi unike për të ndryshuar diçka. Tani le të marrim një vendim: Kur të kthehem në kishën time, dua të jem dikush tjetër. Dua të bëj disa rregullime Brenda vetes time. Le ta marrim atë vendim dhe pastaj le t'i përbahemi atij.

Pika e fundit përsa i përket temës së ndryshimit: Unë e di se gjatë kësaj kohe ka shumë që i ndjekin shërbesat fetare nëpërmjet internetit. Shpresojmë që të gjithë të mund të

shohin se si ka ndryshuar Kisha. Më shumë se kurrë më parë, Jezu Krishti është në qendër dhe në fokusin e saj. Ju lutemi ta ndiqni nxitjen e Shpirtit të Shenjtë dhe nëse keni mundësi, ejani në shërbesat fetare dhe bashkohuni me ne. Ne dëshirojmë që të gjithë ju, përfshirë edhe ata që nuk janë apostolikë të rinj, të marrin menunë gjithëpërfshirëse (All-inclusive). Amen.

MENDIME KYCE

Krishti vepron në Kishë nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Fryma e Shenjtë na bën të aftë për t'i shërbyer Krishtit dhe për të dashtë tjetrin.

Uniteti i Kishës reflekton unititin e Trinisë së Perëndisë.

As shenjë e as ndëshkim

Të lutesh për ata që vuajnë, të falënderosh ata që ndihmojnë dhe ata që besojnë në Zot - kjo është ajo që kërkon apostuli kryesor në krizën e Koronës. Dhe ai e bën shumë të qartë përsë nuk dëshiron ta dëgjojë, ta shikojë ndryshe interpretimin e Pandemisë.

Kam lexuar se tashmë janë infektuar miliona njerëz. Qindra mijë kanë vdekur tashmë. Dhe Pandemia nuk po pushon, por vazhdon. Kjo gjë shkakton shumë halle e vuajtje. Bëhet fjalë për shëndetin, bëhet fjalë për jetën. Edhe pasojat ekonomike nuk mund të vlerësohen si duhet nga perspektiva e sotme.

Sigurisht, unë jam gjithashtu i vetëdijshëm se për shumë njerëz në Afrikë, Venezuelë dhe Azi, kriza e koronës është vetëm një milje më shumë në listën e gjatë, shumë të gjatë të plagëve ku ata janë të ekspozuar. Po përmend vetëm një shembull: Vëllezërit në Afrikë më kanë raportuar, se vetëm vitin që shkoi kanë vdekur në Afrikë nga fruthi 140.000 fëmijë.

Çfarë mund të themi për këtë? Si reagojmë ne?

Në radhë të pare marrim pjesë me gjithë zemër në hidhërimin e këtyre njerëzve, që janë prekur nga fatkeqësia. Ne lutemi për të gjithë ata, të cilët janë në nevojë. Si të krishterë apostolikë të rinj në i përbahemi në mënyrë korrekte të gjitha rregullave të administratës shtetërore. Dhe kjo është shumë e rëndësishme, që ne edhe atje të jemi shembull. Ne u jemi jashtëzakonisht mirënjoës shumë njerëzve, të cilët angazhohen me vetëmohim të madh për të tjerët dhe lutemi edhe për ta.

Eshtë gjithashtu e rëndësishme për mua të sqaroj edhe një herë, se ne nuk e shohim këtë krizë të Koronës si një shenjë të kohërave që parashikojnë fundin e botës ose ardhjen e Jezu Krishtit. Bibla nuk thotë asgjë për Koronën! Besimi ynë në kthimin e afërt të Jezu Krishtit nuk bazohet në shenja, por në deklaratat e Jezu Krishtit dhe në veprën e Frymës së Shenjtë.

Ka edhe njerëz që mendojnë se kriza e Koronës është një ndëshkim që Zoti u dërgon njerëzve. Një thënie e tillë

nuk rrjedh nga Fryma e Shenjtë. Fryma e Shenjtë flet për Zotin si Perëndia e dashurisë, jo si një Zot që dëshiron të ndëshkojë njerëzit.

Edhe një herë: Nuk ka asgjë të shkruar në Bibël rreth krizës së Koronës. Por Bibla dhe Fryma e Shenjtë na tregojnë se çfarë të bëjmë në një situatë të tillë: Ne i besojmë Zotit dhe mbetemi besnikë në ndjekjen e Jezu Krishtit.



Foto: Marcel Felde

DAVIDI U VAJOS DHE U BË MBRET

SIPAS 1. SAMUELIT 16,1-13

Davidi ishte më i vogli i tetë vëllezërve. Ai ruante delet e atit të tij Isai. Davidi kujdesej që asnjë dele të mos largohej nga tufa dhe i dëbonë kafshët e egra që i afroheshin tufës së tij.

Një ditë Perëndia dërgon në Betlehem profet Samuelin. Ai i tha atij: „Shko te Isai. Njëri prej djemve të tij do të jetë mbreti i ardhshëm i Izraelit. Merr me vete një viç dhe there e haje me Isain dhe djemtë e tij. Unë do të tregoj pastaj se cilin prej djemve do të vajosësh për mbret.“

Samueli veproi ashtu siç i tha Zoti. Në Betlehem Samueli, Isai dhe djemtë e tij e flijuan viçin. Samueli vështron Eliabin. Ai mendon: Me siguri që ky do të bëhet mbreti i ri. Eliabi është i madh dhe i fuqishëm.



E megjithatë, Perëndia i thotë që ky nuk është parashikuar për të qenë mbreti i ri.

Isai thërret njërin djalë pas tjetrit. Kështu që përpara Samuelit dalin shtatë djemtë e tij. Por Zoti nuk i bën asnje shenjë atij për asnjërin prej vëllezërve.

„Kaq djem ke?“, pyet Samueli. „Kam edhe një djalë“, përgjigjet Isai, „është më i vogli. Davidi

është në fushë dhe ruan delet.“ „Atëhere thirre edhe atë“, thotë Samueli.

Sapo Davidi hyn brenda, Zoti thotë: „Ky është. Vajose dhe bëje mbret.“

Kështu që mbret u bë më i vogli prej tyre, bariu i deleve, pasi Zoti e kish zgjedhur atë. Dhe Fryma e Perëndisë zbriti mbi Davidin dhe qëndroi me të.



PËR VIZITË TEK SUCCESS NE NYOR GBANWEA (LIBERI)

Këtu jam unë me shokët e mi. Motrat e vëllezërët e mi janë po në këtë fotografi. Mbrapa nesh qëndron xhaxhai im, ai më jep mësimet e fesë mbas shkolle në shtëpi.

Unë quhem Success, jam tetë vjeçë. Unë banoj në Nyor Gbanwea, një fshat i distriktit Nimba. Vendi ku unë jetoj quhet Liberi. Me siguri që shumë prej jush nuk keni dëgjuar asgjë për atdheun tim. Liberia gjendet në Afrikën Perëndimore. Në vitet 1820 u kthyen dhe zunë vend këtu të lirë të gjithë skllevërit nga Amerika, prej këndej rrjedh edhe emri Liberia (nga latinishtja që do të thotë „i lirë“).



Fotografi: private

Këtu shikoni babain tim Abraham (37), nënën time Genetta (28), vëllanë tim Deazee (11) si dhe motrën më të vogël. Edhe ajo quhet po kështu si unë Success. Në mes të fotografisë së familjes qëndroj unë.

Ja këtu po më shikoni mua duke ngrënë oriz me gjalp palme, është ushqimi im i preferuar. Orizi është ushqimi ynë bazë në Liberi. Përveç kësaj këtu në Nimba han secili Gleag-gbar, i njojur gjithandjej si GB. Prodhohet nga Manioku.

Mua më pëlqejnë shumë kafshët shtëpiake. Kam një qen, që quhet Frisky, një mace dhe një dhi.

Kjo është shtëpia ime, ku unë banoj së bashku me prindërit. Shtëpia jonë ka tri dhoma.






Ne ecim në këmbë rreth shtatë kilometra për të mbledhur dru për gatim. Gjyshja na shoqëron, pasi prindërit janë shumë të zënë me punë në arë.

Kjo është shkolla ime. Unë shkoj në shkollën fillore shtetërore, e cila është vetëm tre kilometra larg fshatit tim. Babai më çon çdo mëngjes atje. Unë jam në klasën e dytë. Mësuesja ime quhet znj. Reeves dhe është shumë e dashur.

Bashkësia jonë quhet Gbanwea. Ne nuk kemi ndërtesë si kishë; shërbesat fetare i bëjmë në verandën e priftit tonë. A më gjetët se ku jam në foto?

Të dielave shkojmë në shkollën e së dielës. Mësuesja jonë Lucia na do shumë dhe është shoqja jonë më e mirë. Një herë në muaj, ne fëmijët e shkollës të së dielës, mbas shërbesës bëjmë një lojë me role të ndryshme. Këtu kemi treguar historinë e Jezusit, kur u lau këmbët dishepujve të tij.



Tetorin e kaluar erdhi për vizitë në Monrovia, kryeqyteti i Liberisë, apostuli ynë kryesor. Prindërit e mi dhe unë së bashku me shumë motra e vëllezër të distriktit tonë udhëtuam për më shumë se 400 km, për të marrë pjesë në shërbesën e tij. Qe vizita e parë e një apostuli kryesor në vendin tonë. Ne u ndjemë mëse të bekuar.






Foto: Oliver Rütten

| Thirrje hyjnore dhe administrim i mençur i postit

"Zoti të thërret në detyrë - kjo është akoma edhe sot një dëshmi e besimit tonë," tha apostuli kryesor Jean-Luc Schneider. Në shkrimin e tij udhëzues ai i referohet përgjigjeve të marra prej lutjes si dhe përvojës së ndihmës hyjnore. Sidoqoftë, gjithashtu sqaron se si mund të trajtohen vetë-dyshimet dhe vështirësítë motivuese. Këshilla për vëllezërit e administratës dhe për vëllezërit dhe motrat e besimit.

Një nga detyrat e Apostulit kryesor është forcimi i vëllezërve të tij. Kush janë vëllezërit e mi tani? Para së gjithash, vëllezërit e mi janë bashkëpunëtorët e mi më të ngushtë, përkatesisht Apostujt e distrikteve dhe ndihmësat e tyre. Eshtë shumë e rëndësishme përmua të jem një mbështetje e vërtetë përmata. Vëllezërit e mi janë të gjithë apostuj dhe të gjithë vëllezërit e tjerë të administratës. Forcimi i tyre ndodh ndër të tjera, duke i ndërgjegjësuar ata vazhdimisht përmirësuar. Besimi në këtë thirrje bazohet në

- artikullin e parë të besimit, i cili shpreh besimin tonë te Zoti i Plotfuqishëm;

- artikujt e katërt dhe të pestë të besimit, të cilët thonë se Jezusi sundon Kishën e tij dhe që Zoti zgjedh ata që janë thirrur përmirësuar një post apo detyrë.

I Përzgjedhur, jo si rezultat i mungesës, i nevojës

Kudo ku numri i besimtarëve fillon të bjerë, ndodh që një vëlla administratë mendon se ai ishte zgjedhur përmirësuar, sepse ai ishte i vetmi në dispozicion. Nga pikëpamja njerëzore, një mendim i tillë mund të duket

i justifikuar, por druajtja jonë nga Zoti na mëson ndryshe. Zoti është i gjithëfuqishëm: "çfarë ai do, ai e bën si në qill ashtu edhe në tokë" (Psalmi 135, 6). Zoti është i Përjetshëm dhe i Plotfuqishëm: Në sytë e tij e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja janë njësoj të pranishme. Ne besojmë se Zoti ka zgjedhur ata që janë thirrur t'i shërbijnë Atij. Ai i ka rregulluar gjithçka, në mënyrë që ata të jenë aty ku i duhen, në kohën që ai ka përcaktuar. Vëllezër të tjerë kanë dyshime për zgjedhjen e tyre, sepse janë të bindur se nuk plotësojnë (ose nuk plotësojnë më) kërkuesat e profitit të postit së tyre dhe fushën e veprimittarisë.

Do të kishte kuptim që vëllezërit e administratës të ishin kompetentë në kujdesin shpirtëror dhe në mësimin e doktrinës, dhe unë inkurajoj të gjitha nismat që shkojnë, që zhvillohen në këtë drejtim. Sidoqoftë, nuk duhet t'i bëjmë vëllezërit e administratës të ndjehen fajtorë. Për shembull, do të ishte plotësisht e papërshtatshme të pretendosh se rënia e frekuentimit në kishë vjen si rezulatat i mungesës së kompetencës së vëllezërve. Një pretendim i tillë do të relativizonte gjithëfuqinë e Zotit, sepse e kaluara ka treguar shpesh, se Zoti mund të arrijë gjëra të mëdha përmes njerëzve të papërsosur. Së dyti, një pohim i tillë do të ishte i padrejtë dhe fyes për vëllezërit mbasi, në fund të fundit, ata nuk e kërkuar vetë postin, nuk kandiduan për detyrë, porse ndoqën thirrjen e Zotit. Më shumë se kurrë, vëllezërit e administratës duhet të ndjejnë vlerësim, inkurajim dhe dashuri nga Apostujt e distrikteve të tyre.

Të thirrur, jo të punësuar

Në vendet ku puna e Zotit është ende "e re", ndodh që disa vëllezëri e shohin veten fillimi si bashkëpunëtorë të "punësuar" të eprorëve të tyre, dhe jo si shërbëtorë të thirrur nga Jezu Krishti. Unë u bëj thirrje apostujve që kanë këto vende në ngarkim të bëjnë atë që është e nevojshme përmes mësimeve dhe sjelljes së tyre, në mënyrë që thirrja hyjnore të jetë baza e emërimit të vëllezërve dhe të përcaktojë veprimittarinë e tyre.

Nga besimi në thirrjen hyjnore nuk mund të nxirret konkluzion se vetëm Zoti është ai që vepron. Trinia e Perëndisë zgjedh vëllain dhe Fryma e Shenjtë ia komunikon këtë zgjedhje Kishës. Në këtë rast, vëllezërit propozohen nga vëllezërit e administratës përgjegjës për atë vend dhe apostuli vendos për emërimin e tyre. Prandaj është e domosdoshme që këta vëllezëri ndihmësa të kërkojnë Frymën e Shenjtë dhe të shenjtërohen para se të vendosin të zgjedhin një vëlla në shërbim.

Tradisionalisht, ne priremi të jemi dyshues ndaj një vëllai që shpreh dëshirën për të marrë një post. Një reagim i tillë

është i kuptueshëm, pasi posti nuk është një mjet për ta nxjerrë veten në plan të parë. Sidoqoftë, do të ishte gabim që thjesht të largohesh nga vëllezër të tillë. Përkundrazi, duhet të bëjmë përpjekje t'i njohim më mirë ata. Nëse ata janë të sinqertë, ne do të ishim të pamend të mos kërkoni ndihmën e tyre!

Të bashkuar, jo vetëm

Disa vëllezër janë demotivuar nga vështirësitë me të cilat përballen gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ne duam t'i forcojmë ata, duke i kujtuar ata se Jezusi na ka thirrur për të marrë pjesë në vuajtjet e tij, por edhe në gëzimet e tij: "Shumë të dashur, mos ju duket çudi për provën e zjarrtë që u bë ndër ju për t'ju provuar, se si ju ndodhi diçka e jashtëzakonshme. Por gëzohuni, duke qenë pjesëtarë të mundimeve të Krishtit, që edhe në zbulesën e lavdisë së tij të mund të gëzoheni dhe të ngazëllenoheni" (1 Pjetri 4, 12–13).

Vuajtjet që ne kalojmë duhej t'i duronte edhe Jezusi. Ashtu si ai,

- edhe ne jemi të eksposuar ndaj vështirësive të jetës së përditshme; Angazhimi ynë ndaj punës së Zotit nuk na i kursem ato (Mateu 8,20);
- ne nuk prano hemi dhe as nuk vlerëso hemi gjithmonë (Marku 3,21);
- ne përballemi me mosmirën johje (Luka 17,17);
- ne nganjëherë hasim në keqkuptim (Mateu 16, 8);
- ne pësojmë humbje;
- ne vuajmë kur bijtë e Perëndisë janë të ndarë;
- ne ndonjëherë jemi krejtësisht të vetëm ...

Sidoqoftë, ne gjithashtu përjetojmë të njëjtat gëzime si Jezusi:

- na dëgjohen lutjet;
- përjetimi i ndihmës hyjnore, për shembull kur shërbjmë në altar;
- bashkimi me Zotin gjatë lutjes;
- bashkimi vëllazërор.

Nëse jemi të gatshëm të vuajmë me dhe për Jezusin, mund të mbështetemi gjithashtu në ndihmën e tij. Vëllai që beson në thirrjen e tij dhe beson në Zot, nuk e len veten t'u hedhë barrën e postit të tij atyre që e rrethojnë. Nga ana tjeter, ne nuk duam të kemi druajtje të ndajmë me të dashurit tanë gëzimet që ne përjetojmë. Ne dëshirojmë që edhe ata të kenë pjesë në sovranitetin dhe besimin në Zot që ne përfitojmë nga ushtrimi i detyrës, i postit tonë.

Një Kishë, ku njerëzit ndjehen mirë

Apostuli kryesor Schneider tha se përshtatja apo përafrimi i jetës së njeriut me Ungjillin e Jezu Krishtit dhe përgatitja për kthimin e tij dhe jetën e përjetshme, është programi i Kishës. Dhe kjo gjithmonë çon në ndryshime në jetën e përditshme të Kishës. Në shkrimin e tij udhëzues, drejtuesi i kishës ndërkombe të shikon përsëri vitet e kaluara dhe përqendrohet apo ve në qendër të vëmendjes një detyrë të lënë pas dore.

Gjatë emëritimit tim si apostul kryesor unë u shpreha që programi im rreth vizionit të kishës sonë përmblidhet kështu: Ne dëshirojmë që "të jemi një kishë në të cilën njerëzit të ndjehen mirë, të qetë dhe - të mbushur me Shpirtin e Shenjtë dhe dashurinë për Zotin – ta jetojnë jetën e tyre sipas Ungjillit të Jezu Krishtit dhe të përgatiten për kthimin e tij dhe jetën e përjetshme." Unë do të dëshiroja ta thelloja këtë mendim:

Para së gjithash, do të doja të vlerësoja shumë paraardhësit e mi për punën e shkëlqyeshme që kanë bërë. Të udhëhequr nga Fryma, këta apostuj kryesorë zhvilluan më tej njohuritë tona dhe i mundësuan Kishës që të përbushë më mirë detyrën që Zoti i kishte dhënë asaj.

Nuk është qëllimi im të kritikoj të kaluarën, por të tregoj rrugën që është pëershkuar. Ka qenë një kohë kur thuhej se Zoti do të vinte përsëri, sapo të vulosej "shpirti i fundit". Të ishe gati do të thoshte të kishe marrë vulën, të ishe besnik dhe të mposhtje botën. Besnikëria konsistonte në thelb në ndjekjen e të gjitha shërbesave fetare dhe të sillje sakrificën tënde. Termi "botë" nënkuptione në atë kohë gjithçka që ndodhje jashtë kishës. Të mposhtje botën do të thoshte "ndarje me botën e jashtme". Misioni i Kishës në përgjithësi, dhe i apostujve në veçanti, ishte të vulosnin njerëzit dhe të mbronin besimtarët nga ndikimi i "botës". Qëllimi i shërbesave fetare ishte së pari të na mësonte; pra këtu bazohej edhe rëndësia apo kuptimi i predikimit dhe i shërbimit. Për këtë shkak, Darka e Shenjtë kaloi si në plan të dytë ...

Bashkësia e shpallur

Sot kemi një pamje krejt të ndryshme të përgatitjes së bashkësisë-nuse. Qëllimi ynë është të luftojmë kundër mëkatit dhe "Adamit të vjetër", të përshtatemi me Ungjillin dhe të bëhem si Jezusi. Dashuria e Krishtit bëhet pra masa e përsosmërisë. Misioni i kishës, siç përcaktohet ai sot, e pasqyron këtë zhvillim. Para së gjithash, çështja është për të arritur të gjithë njerëzit e për t'u mësuar atyre Ungjillin e Jezu Krishtit dhe për t'iu dhruuar atyre sakramenetet. Sidoqoftë, kisha gjithashtu duhet t'i lejojë besimtarët të provojnë dashurinë e Zotit, si dhe bashkimin e ngrohtë dhe gëzimin për t'i shërbyer Perëndisë dhe tjetrit. Zhvillimi i liturgjisë sonë e merr në konsideratë këtë shqetësim: duke theksuar festimin e Darkës së Shenjtë, ne kemi dashur t'i bëjmë të mundur besimtarëve të përjetojnë edhe mëngushtë bashkimin me Krishtin dhe me njëri-tjetrin.

Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që kemi arritur në fund të përpjekjeve tona për të përshtatur Kishën në misionin e saj; në fakt, katekizmi e paraqet Kishën në dy mënyra:

- së pari si një "institucion" hyjnor, misioni i të cilit është të bëjë të arritshëm shpëtimin për njerëzit;
- por pastaj edhe si një bashkësi që do t'i ofrojë adhurim dhe lavdërim Zotit.

Bazuar në traditën tonë, ne vumë theksin në pikën e parë dhe e pamë kishën si një "institucion shpëtimi". Përsa i përket këtij aspekti ne kemi theksuar gjithmonë - dhe me të drejtë - rëndësinë e madhe të apostulatit dhe të postit.

Bashkësia që lëvdon dhe adhuron Perëndinë

Në lidhje me pikën e dytë, domethënë ta shohim Kishën si një bashkësi që lavdëron Perëndinë dhe adhuron Zotin, ne mund dhe duhet të bëjmë përparime. Në përgjithësi, ne nuk kemi zhvilluar ende aq sa duhet dimensionin e një kishe të bashkuar si "trupi i Krishtit" ose "populli i Perëndisë". Si e tillë, e gjithë Kisha është thirrur për t'i shërbyer Perëndisë. Të gjithë ata që kanë lindur përsëri nga Uji dhe Fryma janë thirrur të japid një dëshmi të gjallë të Ungjillit të bashkuar me apostujt, përmes fjalës dhe veprave dhe kështu të mbështesin apostujt (KNK 7.1). Të adhurosh Zotin ose të japësh një dëshmi të gjallë të Ungjillit nuk kërkohet që të kesh apo të mbash një post apo detyrë. Këtu termi "post" humbet kuptimin e tij në favor të termit "shërbim".

Vizioni ynë për Kishën Apostolike të Re ka të bëjë me këtë dimension të përbashkët, i cili thotë se njerëzit e mbushur me Shpirtin e Shenjtë dhe me dashurinë për Zotin duhet të përgatiten për kthimin e Jezusit dhe të orientojnë jetën e tyre sipas Ungjillit.

Këtu duket se dashuria e vërtetë luan një rol vendimtar në përgatitjen e nuses së Krishtit. Dhe dashuria është e paimagjinueshme pa vepra. Për t'iu mundësuar besimtarëve të përgatiten për kthimin e Zotit, Kisha duhet t'u japid atyre mundësi për të bërë vepra dashurie. Ne duhet t'u japid mundësi besimtarëve të përjetojnë gjëzimin për t'i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve. Dashuria ndaj tjetrit është një shërbim, të cilin Kisha e krishtit ia ka ngarkuar besimtarëve. Ne nuk duhet të anashkalojmë këtë mision të Kishës së Krishtit.

Shërbimi ndaj bashkësive

Shërbimi ndaj Zotit dhe fqinjët do të thotë para së gjithash të angazhohesh në kishë. Shumë nisma në këtë fushë nuk arrijnë qëllimin e tyre vetëm sepse vëllezërët tanë të administratës janë të angazhuar, të përfshirë në punë të ndryshme e të shumta sa nuk mund të imagjinohet. A duhet të presim me të vërtet prej vëllezërve tanë të administratës

që ata të kujdesen për gjithçka? Kryerja e një bamirësie nuk ka pse të kërkojë patjetër një post. Shumë punë mund të bëhen pa përfshirë hierarkinë e postit.

Dashuria ndaj tjetrit nuk ndalet te dera e kishës. Si funksionon bamirësia jonë jashtë Kishës? Të praktikosh Ungjillin do të thotë gjithashtu të ndihmosh të varfërit dhe ata që vuajnë. A jemi gjithmonë të besueshëm në këtë fushë? Financimi i aksioneve humanitare është një gjë e mirë, por sigurisht që nuk është e mjafueshme. Nuk kam ndërmend të imitoj kishat e tjera të krishtera: ne nuk kemi as mjete as përvojë për ta bërë këtë. Nuk ka të bëjë me konkurrencën me ta, dhe aq më pak për të na vënë ne në qendër të vëmendjes. Thjesht pyes veten se çfarë dëshiron Zoti që ne të bëjmë. Dhe ne duhet ta integrojmë këtë pyetje në diskutimet tona në të ardhmen, nëse kjo ka të bëjë me të kuptuarit tonë të postit dhe shërbimit ose me organizimin e veprimtarive në kishën tonë. Nga ana ime, unë gjithashtu e shoh këtë si një mundësi për t'iu afruar të krishterëve të tjerë. Padyshim që nuk është e kotë edhe të diskutosh me kishat e tjera rrëth pyetjeve teologjike, por për mua duket edhe më e rëndësishme që të krishterët të bashkojnë forcat e tyre për të bërë të mira ...

Përbledhja:

- Eshtë detyra e Kishës që t'u japid shpëtimin njerëzve. Në shërbesat fetare, apostujt dhe ndihmësat e autorizuar prej tyre shpallin fjalën dhe administrojnë sakramenton. Shërbesa fetare është qendra e jetës së kishës.
- Eshtë gjithashtu detyrë e kishës t'i ofrojë adhurim dhe lavdërim Zotit. Kjo është detyrë e të gjithë besimtarëve. Gjatë shërbesave fetare, bashkësia shpreh lëvdata dhe adhurim përmes lutjes së zakonshme që bën drejtuesi i shërbësës. Sidoqoftë, adhurimi dhe lavdërimi mund të ofrohen edhe pa ndihmën e një vëllai administratë.
- Në mënyrë që të përgatitet për kthimin e Zotit, bashkësia-nuse duhet të bëjë, të tregojë vepra dashurie. Eshtë pjesë e detyrës së Kishës për të mundësuar besimtarët t'i shërbejnë Perëndisë dhe fqinjët të tyre. Ne duhet të mendojmë për mënyrat më të mira të mundshme për ta realizuar këtë.

Masthead

Autori: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Peter Johanning

Shpëtoni fëmijët tanë: Për Ditën Botërore të Fëmijëve 2020

A kanë nevojë fëmijët për ditën e tyre përkujtimore? Kombet e Bashkuara e pohojnë këtë dhe me të vërtetë: Bota nuk u përket fëmijëve, megjithëse duhet t'i përkiste atyre. Vërejtje dhe mendime kundër trendit.



Foto: ©Pixel-Shot - stock.adobe.com

Në fund të fundit, Dita Botërore e Fëmijëve është e shënuar në 145 kalendarët zyrtarë të disa qeverive. Ky është një takim për të kujtarar nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Kombet e Bashkuara kanë regjistruar për këtë 20 nëntorin e çdo viti - kjo është dita në të cilën Asambleja e Përgjithshme e KB miratoi Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në 1989. "A kanë të drejta fëmijët?" pyesin të rriturit. "Po, sigurisht që kemi", përgjigjen vogëlushët. «Atëherë pse duhet ta kujtojmë?» - «Sepse ne nuk duam që ju ta harroni atë! Mos harroni: çdo dhjetë sekonda, si rezultat i urisë, vdes ende një fëmijë: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, një i vdekur."

E drejta e fëmijërisë

Çfarë të drejtrash janë këto? Shumë nga këto janë të rëndësishme: E drejta e fëmijërisë, për shembull. Edhe pse kohërat e punësimit, të shfrytëzimit të fëmijëve janë kryesisht të jashtëligjshme, ato ende nuk janë ndalur fare. Duart e vogla të fëmijëve që kontribuojnë për të jetuar, kanë shumë pak kohë për gjëra më të rëndësishme, siç është loja p.sh. Në mijëvjeçarin e tretë, tabllo me fëmijë që luajnë nuk duhet të janë piktura anakronike të një së kaluare romantizuese. "Fëmijët në muze" - çfarë ideje e tmerrshme! UNICEF vlereson se dhjetë përqind e fëmijëve janë ende të detyruar të bëjnë punë shfrytëzuese - në minierat nëntokësore të bakrit, në fabrikat e tekstilit që mezi meritojnë emrin e tyre, në plantacionet e kakaos. Të rriturit do të ishin shumë të shtrenjtë - dhe klientët në vendet e konsumit preferojnë më shumë produkte të lira. Një rrëth i lig, djallëzor!

E drejta për të qenë në gjendje të thonë jo është gjithashtu një krijues identiteti për jetën e tyre. Një fëmijë që gjithmonë pajtohet me mendimin e tjeterit nuk ka asnë mendim të vetin. Vetëm me një jo të qartë ai bëhet personalitet. Dhe një jo e tillë, madje nuk ka pse të justifikohet apo faktohet për të qenë e vlefishme. "Jo është jo" - pikë. Por kushdo që dëshiron të rritë fëmijë për të qenë në gjendje të marrin pjesë dhe të pajtohen ose jo me mendimin e tyre, duhet t'i lejojë ata të vendosin vetë. Një fëmijë i cili lejohet, mësohet të thotë jo, do t'i thotë po vetes së tij.

Për çfarë kanë nevojë fëmijët?

Ato për të cilat fëmijët kanë me të vërtetë nevojë,

- janë shokët, këshilluesi, mësuesi, të kenë kohë për veten e tyre si dhe kohë për t'i dëgjuar ata.
- janë vendi apo streha ku i garantohet streha, paqja dhe mbrojtja.



Foto: Susanne Dietmann / Kindermissonswerk

■ janë ëndrrat, që aty-këtu mund të kthehen në realitet. Kur ëndrrat mësojnë të fluturojnë, ja vlen edhe udhëtimi drejt horizontit. Fëmijët kanë nevojë për njerëz dashamirës, të cilët janë bujarë, pa qenë të njëanshëm, të cilët janë të interesuar për botën e tyre pa i kritikuar vazhdimisht, të cilët mund ta bëjnë veten të vogël për të parë përmes syve të fëmijës. Vetëm në këtë mënyrë dhe jo vetëm përmes ligjeve ose urdhraive zyrtarë, të drejtat e fëmijëve mund të bëhen të drejta, e jo vetëm detyrime.

Duart duhen për bekim e jo për mbrojtje, për pengim

Kujdes: Disa kultura e përjashtojnë mendimin, jo-në e fëmijëve. Kjo vlen madje edhe për shumë kultuara të kohës së sotme. Edhe pse është e shkruar gjithçka, e zeza mbi të bardhë, realiteti apo e vërteta flet krejtësisht ndryshe. Në artikujt e besimit të krishterë Jezu Krishti ka vënë masën: „Fëmijët u mblođhën rreth tij dhe ai vendosi duart mbi kokat e tyre dhe lutej. Dishepujt përpinqeshin t'i largonin ata

prej tij. Por Jezusi u tha: Lerini fëmijët mos i pengoni ata të vijnë drejt meje; pasi atyre u përket mbretëria qiellore. Dhe ai vendosi duart mbi kokat e tyre dhe u largua më tutje“ (Mateu 19,13-15). Kjo nuk është e varur nga asnjë lloj kulture.

Përsa kohë një fëmije i duhet të punojë në minierat e bakrit, kemi nevojë për ditën ndërkontaktare të fëmijëve. Përsa kohë ka të rritur, që jo-në e fëmijëve e sanksionojnë si negative dhe të tepërt, kemi nevojë për këtë ditë përkujtimore.

Nga Bibla

Beteja e grades, e rangut midis dishepujve (Mateu 18: 1-5): «Në të njëjtën orë dishepujt erdhën te Jezusi dhe thanë: Kush është tani më i madhi në mbretërinë hyjnore? Pastaj ai thirri një fëmijë dhe e futi në mes të tyre dhe tha: "Me të vërtetë po ju them, se nëse nuk pendoheni dhe bëheni si ky fëmijë, ju nuk do të hyni në mbretërinë e qiejve". Kush përulet tani dhe bëhet si ky fëmijë, ai është më i madhi në mbretërinë hyjnore. Dhe kushdo që pranon një fëmijë të tillë në emrin tim, më pranon mua".



New Apostolic Church
International

